



Republika Kosova-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština štrpce

Komuna e Shtërpçës

Municipality of Strpce



Në mbështetje të nenit 11, 12, dhe 40 të Ligjit nr. 03/ L - 040 për vetëqeverisjen lokale , Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.03/2020 për Transparencë në Komuna, në bazë të dispozitave të Udhëzimit Administrativ të (MPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik në Komuna, nenit 8 të Rregullores për Transparencë të komunës së Shtërpçës 01-Nr 895 të datës 14.07.2010 e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren nr.01-16-620 të datës 01.03.2013 si dhe nenit 15 dhe 34 të Statutit të komunës së Shtërpçës 01-Nr. 898 të datës 14.07.2010, Kuvendi i Komunës në seancën e mbajtur më 27.04.2022 miratoj këtë:

VENDIM

PËR VËNIEN NË KONSULTIM PUBLIK TË PROPOZIM RREGULLORES PËR PËR TRANSPARENCË

Neni 1

Me këtë Vendim miratohet propozim “Rregullorja për Transparencë” dhe si PROPOZIM, vihet në konsultim publik.

Neni 2.

Konsultimi publik për “Rregullorja për Transparencë” do të zgjasë se paku 30 dite nga dita e publikimit të këtij vendimi në tabelën e shpalljeve dhe në web faqen e komunës së Shtërpçës dhe debati me qytetare do të mbahet më 17.05.2022 ora 10 në sallën e Kuvendit të Komunës së Shtërpçës.

Neni 3.

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe do të shpallet në tabelën e shpalljeve publike dhe në Web-faqen e KK të Shtërpçës.

Kryesuesi i Kuvendit

Predrag Grbic

